



201 21.09.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

6434
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 22⁰⁹ 2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr.76

Data: 16.09.2022

“Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin, krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Diber”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arifim Miki





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 76 Datë 16/09/2022

“Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin, krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Dibër”.

Në mbështetje të nenit 29 dhe nenit 54, germa “K” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar, dhe relacionit të administratës, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **16.09.2022**, me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:


1. Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin, krijimin e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Dibër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Sigurisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
4. Vendimi u shpall sot me datë 16.09.2022.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



PREFEKTI I QARKUT DIBËR



Nr.921/1 prot

Peshkopi më 26.09.2022

Lënda: Për vendimin Nr.76, datë 16.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

Drejtuar: Bashkisë Dibër.

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut ",nemi 16, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",si dhe ligjit nr.108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar,pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.76, datë 16.09.2022 "*Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin ,krjimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Dibër*", vendosa miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi që është përgejësi direkte administrativo-ligjore e administratës së bashkisë.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI**

Nr. ____ Prot

Date _____.____.2022

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

Të nderuar këshilltar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për shqyrtim projekt vendimin dhe relacionin, për “ Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin, Krijimin e Këshillit Vendor Për Sigurinë Publike në Bashkinë Dibër”

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETARI

Rahim SPAHIDERISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

Nr. ___ Prot

Data _____.2022

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ Data 08/082022

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN,
KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DIBËR”**


Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ /2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 29, dhe nenin 54 gërma “k” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” I ndryshuar, ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” I ndryshuar, dhe sipas relacionit të administratës.

VENDOSI:

1. Të miratohet rregullore për organizimin dhe funksionimin, krijimin e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Dibër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë dhe Këshilli i Sigurisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Rahim SPAHJU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

Nr. ____ Prot

Data ____ . ____ . 2022

RELACION
PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN,
KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DIBËR”**

Të nderuar këshilltarë!

Këshillat vendor të sigurisë publike (në vijim KVSP) janë struktura konsultative mbi çështjet e sigurisë publike në nivel vendor që funksionon pranë Bashkive. Ato janë forume me përfaqësues të institucioneve publike, institucioneve fetare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga ku kërkohet përgjegjësi qytetare, përgjegjësi institucionale për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre sipas tagrit që secili institucion ka.

Duke pasur parasysh se zhvillimi ekonomik dhe social I vendit lidhet ngushtë me forcimin e sigurisë publike, uljen e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, eliminimin e dhunës dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme, luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm, luftën ndaj kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike, apo përballjen me çdo fenomen tjetër krimi dhe paligjshmërie kërkojmë me anë të këtij projekt vendim të realizojmë ngritjen e KVSP pranë Bashkisë Dibër.

Ngritja e Këshillave Vendore të Sigurisë Publike në nivel lokal krijon premisat për një qasje të re strategjike lokale ndaj fenomeneve të pasigurisë, ku sjell:

- 1.Përfitim të drejtpërdrejt për komunitetet.
- 2.Fuqizon bashkëpunimin midis komuniteteve dhe aktorëve qeverisës.
- 3.Nxit ndërveprim për të adresuar çështjet e sigurisë publike.

Kuadri ligjor në të cilin mbështet themelimi I KVSP janë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,
3. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
4. Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik, botuar nga OSCE (2008)
5. Ligji nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” I ndryshuar
6. Ligji nr.108/2014 “Për policine e Shtetit” I ndryshuar

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN, KRIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DIBËR”

Neni 1

Objekti

Objekti I kësaj Rregullore është përcaktimi I përbërjes, detyrave, përgjegjësisve, mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike pranë Bashkisë Dibër.

Neni 2

Baza Ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,
3. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
4. Praktik të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik, botuar nga OSCE (2008)
5. Ligji nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” I ndryshuar
6. Ligji nr.108/2014 “Për policine e Shtetit” I ndryshuar
7. Ligji nr.103/2014 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”
8. Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”
9. VKM nr.930 datë 18.11.2015 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizimit të dhunshëm dhe Planit të Veprimt”

10. VKM nr.1139 datë 24.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”

Neni 3

Përkufizim

Këshilli Vendor për Siguri Publike (KVSP) është një forum I përbere nga të gjithë aktorët vendor, institucionet publike, OJF-të, grupet vendore të interesit dhe qytetarët, I krijuar për të diskutuar për sigurinë publike në vend si dhe për të rritur bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet aktorëve dhe partnerëve të ndryshëm vendor për të zgjidhur çështjet e sigurisë vendore. Fushveprimi I punës së KVSP është I kufizuar vetëm brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Dibrë.

Neni 4

Qëllimi I punës së KVSP-ve

KVSP nuk kanë buxhet të vecantë dhe në të tilla kushte nuk ushtrojnë veprimtari me interes ekonomik.

Qëllimi I KVSP-së, është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në Bashki nëpërmjet:

1. Identifikimit të problemeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik.
2. Identifikimit të pikave të nxeha përsa I përket situatës kriminale, aksidenteve në qarkullimin rrugor, sjelljeve anti shoqërore dhe kundravajtjeve dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve.
3. Përgatitjes së planit dhe zhvillimit të projekteve vjetore të punës në mënyrë që të rritet dhe të përmisohet siguria në komunitet
4. Rritjes së ndjenjës së sigurisë
5. Nxitjes së angazhimit vullnetar në partneritetet publike
6. Krijimit të besimit ndërmjet administratës publike përgjegjëse për sigurinë publike dhe grupeve të komunitetit dhe qytetarëve.
7. Hartimit të rekomandimeve dhe aktiviteteve për rritjen e sigurisë dhe rendit publik drejtuar autoriteteve përgjegjëse
8. Identifikimin e çështjeve që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik

9. Diskutimin e raporteve dhe të dhënave lidhur me sigurinë në bashki dhe identifikimin e masave për adresimin e problemeve

10. Mbështetjes së policisë vendore në zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Vendore për Siguri në komunitet.

11. Diskutimit dhe këshillimit për përcaktimin e buxheitit dhe projekteve që lidhen me ritjen e sigurisë në komunitet, dhe adresimin e këtyre kërkesave OJF-ve apo Organizatave Qeveritare për financim.

Neni 5

Përbërja

Këshilli Vendor I Sigurisë Publike përbehet si më poshtë:

1. Kryetar Kryetari I Bashkisë
2. Anëtar Drejtorja Vendore e Policisë
3. Anëtar Kryetar I Këshillit Bashkiak
4. Anëtar Drejtues I Policisë Bashkiake
5. Anëtar Përfaqësues nga Prefektura
6. Anëtar Përfaqësues I Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar
7. Anëtar Drejtues I Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik
8. Anëtar Drejtues I Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
9. Anëtar Nga një përfaqësues I Komuniteteve Fetare
10. Anëtar Përfaqësues nga Komuniteti I Biznesit
11. Anëtar Përfaqësues të Shoqërisë Civile
12. Anëtar Përfaqësues për Emergjencën dhe Mbrojtjen Civile në Bashki
13. Anëtar Drejtuesi I Drejtorisë Shërbimit Social dhe Strehimit në bashki
14. Anëtar Drejtues I Drejtorisë Ekonomike të Arsimit në Bashki
15. Anëtar Përfaqësues të Mediave Lokale

Në varësi të temave të rendit të ditës mund të ftohen në mbledhje edhe anëtarë të tjerë që nuk janë pjesë e KVSP.

Identifikimi I anëtarëve ose I të fuarve bëhet nga Kryetari dhe/ose anëtarët e tjerë të KVSP-s

Neni 6

Struktura

Këshilli Vendor për Siguri Publike përbehet nga struktura e mëposhtëme:

1. Kryetar
2. Sekretari
3. Grupet e punës
4. Plenumi

Neni 7

Kryesuesi I Mbledhjes

Kryetari I Bashkisë është kryesuesi I KVSP-së. Ai kryeson mbledhjen e KVSP-së, për gatit axhendën në konsultim me sekretarin dhe thërret mbledhjen. Ai nënskruen në emër të KVSP-së ,dokumentet zyrtare (rezolutat, fjesat, deklaratat përshtyp dhe media, etj.). Në bashkëpunim me nënkryetarin, kryesuesi informon publikun për aktivitetet e KVSP-së.

Neni 8

Sekretari

Sekretari I KVSP-së emërohet nga Kryetari, I cili është punonjës I stafit të Bashkisë, dhe kryen këto funksione:

1. Dërgon fjesat, harton dokumentet dhe të përgatit materialet e nevojshme për mbledhjet
2. Konsultohet me të gjithë anëtarët para mbledhjes dhe finalizimit të axhendes. Cdo anëtar ka të drejtë të përfshijë një temë në rendin e ditës.
3. Shpërndan rendin e ditës dhe dokumentet të gjithë anëtarëve të paktën një javë para mbledhjes.
4. Protokolllon dhe të mban proces verbalin e mbledhjes.
5. Shpërndan të gjithë anëtarëve Procesverbalet e mbledhjeve vendimeve.
6. Realizon publikimin në faqet e internetit të Bashkisë dhe institucioneve të tjera.

Neni 9

Grupet e punës

Për ceshje të vecanta, krijohen grupe pune të posaçme (ad hoc), të përbëra nga përfaqësuesit e institucioneve në KVSP. Grupi I punës do të hartojë dhe formulojë në mënyrë të detajuar raporte, rekomandime, pyetje etj. Në bazë të vendimit të plenumit, si dhe do të ndjekë zbatimin e rezolutave, propozimeve etj, nga autoritetet/ institucionet përgjegjëse. Grupi I punës mbështet sekretarin në detyrimet e tij.

Neni 10

Plenumi

Plenumi është organi vendimmartësi KVSP-së, dhe përbëhet nga anëtarët e tij (neni 5). Plenumi do të mbidhet rregullisht cdo tre muaj. Për raste specifike, organizohet mbledhje me kërkesë të kryetarit ose të shumicës së anëtarëve të KVSP-së.

Neni 11

Vendimarrja edhe procesi I votimit

KVSP mund të mbajë mbledhje nëse në të merr pjesë më shumë se ½ e anëtarëve të Këshillit. Në rast të rezultati të barabartë të votimit, vota e kryesusit është vendimtare. Procesi I votimit është I hapur, dhe nuk lejohet abstenimi

Neni 12

Bashkëpunimi

KVSP informon brenda 3 ditëve punë autoritete / institucionet përgjegjëse (Policinë, Këshillit Bashkiak, Gjykatën, Prokurorinë e Rrethit, Koordinatorin për Cështjet e Dhunës në Familje etj.) mbi gjetje dhe rezultatet e arritura në lidhje me sigurinë dhe rendin publik.

Përvec kësaj, KVSP dërgon rekomandimet për masat që do të merren tek institucionet e përmendura më sipër. Më pas do t'u kërkohet institucioneve që të raportojnë mbi aktivitetet që do të kryhen për të zgjidhur problem e sigurisë publike të diskutuara në KVSP.

KVSP, bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet e lartpërmendura për të arritur rezultate të prekshme për parandalimin e krimeve, sjelljeve anti-shoqërore dhe aksidenteve në qarkullimin rrugor. Nëse është e nevojshme, KVSP ofron në mbledhje përfaqësuesit e institucioneve përkatëse për diskutuar cështjet. Fryma që përshkon organizimin e mbledhjeve dhe komunikimin në mbledhjet e mbajtura nga KVSP është fryma e bashkëpunimit dhe gjithë përfshirjes. Vendimet kanë natyrë këshillimore për institucionet. Megjithatë, të gjithë anëtarët ftohen të marrin në konsideratë këto vendime në planifikimet dhe punën e tyre të përditshme.

Neni 13

Raportimi

Në fund të çdo viti, KVSP informon Këshillin Bashkiak Dibër për aktivitetin e realizuar.

Neni 14

Dispozita Kalimtare

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxerjes së saj.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Dibër.

Konceptoi:

Përgjegjësjë e Sektorit Juridik

Elona Lusha

